




REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA  
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE  
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE  
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) duke u bazuar në nenin 3, paragrafi 1 të Ligjit Nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave si dhe nenin 19, paragrafi 2, të Rregullores për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale KPM-2020/01, me datën 3 tetor 2023, mori këtë:

**VENDIM**

**URDHEROHEN** operatorët e shpërndarjes që menjëherë t'i largojnë nga transmetimi kanalet ARENA SPORT, me qëllim të parandalimit të përmbajtjeve programore të cilat cenojnë interesin nacional dhe sigurinë e përgjithshme në Republikën e Kosovës.

**ARSYETIM**

KPM, me datën 4 nëntor 2020, ka miratuar Rregulloren KPM-2020/01 për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale, qëllimi i së cilës është përcaktimi i rregullave dhe procedurave për shpërndarjen e ofruesve të shërbimeve mediale nga ana e operatorëve, të cilët pavarësisht teknologjisë së përdorur shpërndajnë përmbajtje audio dhe audiovizuale.

KPM, është njoftuar se kanalet Arena Sport, gjatë transmetimit në Republikën e Kosovës, janë shoqëruar me përmbajtje tekstual dhe audiovizuale ("Do të kujtojmë" "Lavdi heronjve") e cila mbështet dhe glorifikon aktivitetin terrorist të grupit i cili ka cenuar interesin nacional dhe sigurinë e përgjithshme të Republikës së Kosovës, veprime këto të cilat janë në kundërshtim me nenin 19, paragrafi 2, të Rregullores KPM-2020/01 i cili përcakton se:

*"Në raste të veçanta, kur një ofrues i shërbimit medial me përmbajtjen e shërbimit të ofruar do të nxisë veprime që cenojnë interesin nacional dhe sigurinë e përgjithshme, KPM do të urdhërojë të licencuarin ta largojë atë menjëherë nga katalogu i ofruesve të shërbimeve mediale".*

Përmbajtjet e tilla të transmetuara në kanalet Arena Sport, paraqesin mbështetje për veprimet terroriste të grupit i cili ka cenuar interesin nacional dhe sigurinë e përgjithshme të Republikës së Kosovës.

Prandaj KPM, duke u bazuar në faktet e lartpërmendura, si masë proporcionale, vendosi si në dispozitivin e këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në datën e nënshkrimit dhe mbetet në fuqi deri në një vendim tjetër të KPM-së.

**Këshillë juridike:** Palët mund të parashtrojnë ankesë në afat prej 30 ditësh, pas pranimit të këtij vendimi, në Bordin për Ankesa. Ankesa nuk e pengon ekzekutimin e këtij vendimi sipas Ligjit të KPM-së Nr. 04/L-44.

Jeton MEHMETI

Kryetar

Komisioni i Pavarur i Mediave



03.10.2023  
data

